

“HAYAL MOTORS” SH.P.K

STATUTI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “HAYAL MOTORS” SH.P.K

Në këtë Statut:

- “Ligji” është Ligji nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- “Statuti” është Statuti i Shoqërisë;

KREU I

Themelimi, Forma Ligjore, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia,

Neni 1

Data e Themelimit, Emri, Forma Ligjore dhe Themeluesit

- (1) Sot, më datë 01/11/2025, Ne, themeluesit kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“HAYAL MOTORS” SH.P.K.** (më poshtë referuar si **“Shoqëria”**);
- (2) Shoqëria ka formën ligjore të Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar, në përputhje me Ligjin. Shoqëria mund të transformohet në një formë tjetër ligjore në përputhje me Ligjin.
- (3) Themeluesit dhe Ortakët e Shoqërisë janë:
 - **EMRAH ÇOBAN**, atësia Mustafa, amësia Hafize, shtetas Turk, lindur në Elazığ / Turqi, më 12/06/1986, banues në Stamboll / Turqi, mbajtës i pasaportës së Republikës së Turqisë me Nr. U26528040, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
 - **BATUHAN GÜNEŞ**, atësia Bekir, amësia Gülbahar, shtetas Turk, lindur në Bağcılar / Turqi, më 24/10/2000, banues në Stamboll / Turqi, mbajtës i pasaportës së Republikës së Turqisë me Nr. U36307298, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë

- (1) Shoqëria Tregtare **“HAYAL MOTORS” SHPK**, ka për objekt të veprimtarisë së saj; Dhënie me qira (rent a car) të automjeteve të çdo lloji, me ose pa shofer. Marrje me qira dhe dhënie me qira të mjeteve motorike tokësore, ujore dhe ajrore. Menaxhim flotash automjesh dhe shërbime logjistike. Transport i udhëtarëve dhe mallrave brenda dhe jashtë vendit. Shërbime taksie, transport turistik, shuttle service, linja të rregullta dhe jo të rregullta. Blerje, shitje, import, eksport i automjeteve të reja dhe të përdorura. Tregtim me shumicë dhe pakicë i automjeteve, motoçikletave, furgonëve, kamionëve, rimorkiove, makinave industriale, bujqësore etj. Shërbime ndërmjetësimi në tregtimin e automjeteve brenda dhe jashtë vendit. Import, eksport, tregtim i pjesëve të këmbimit për automjete të çdo lloji (origjinale dhe alternative). Tregtim vajrash lubrifikantë, baterish, gomash dhe materialesh mirëmbajtjeje automjesh. Hapje servisesh mekanike, elektrike dhe diagnostikuese për automjete. Shërbime riparimi, lyerje, gomisteri, lavazh, kolaudim, asistencë rrugore. Kryerje aktiviteti tregtar me shumicë dhe pakicë për çdo lloj malli të lejueshëm nga ligji. Import – eksport të mallrave industriale, ushqimore, bujqësore, elektronike, tekstile, pajisje profesionale etj. Përfaqësim tregtar të kompanive të huaja në Shqipëri. Agjenci shitjeje dhe distribucioni brenda dhe jashtë vendit. Ndërtim, rikonstrukcion dhe restaurim

objektesh civile, industriale, turistike, tregtare dhe banimi. Ndërtim rrugësh, urash, linjash inxhinierike, rrjetesh elektrike, ujësjellës-kanalizime, struktura metalike etj. Projekte, supervizime, konsulenca teknike dhe inxhinierike. Shitje, blerje dhe administrim pasurish të paluajtshme. Punime të brendshme, arredim dhe mobilim objektesh. Agjenci turistike, organizim guidash dhe shërbime hotelerie. Veprimtari marketingu, reklamash dhe shërbime IT. Konsulencë tregtare, financiare, menaxheriale dhe ndërmjetësim biznesi. Investime në startup-e, projekte zhvillimi dhe partneritete publike-private. Çdo veprimtari tjetër e ligjshme që lidhet drejtpërdrejt ose tërthorazi me qëllimin e shoqërisë, si dhe të bashkëpunojë me persona fizikë dhe juridikë, vendas ose të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

- (2) Objekti i Shoqërisë mund të ndryshohet me Vendim të Ortakëve të Shoqërisë sipas kushteve për ndryshimin e Statutit.

Neni 3

Kohëzgjatja e Veprimtarisë

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar.

Neni 4

Selia e Shoqërisë

- (1) Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: **Rruga e Vilave, Kompleksi White Houses, Nr: 12, H:1, Kat 1, Lundër, Tiranë.**

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali Themeltar

- (1) Kapitali themeltar fillestar i Shoqërisë është **100.00 (njëqind) lekë**. Pjesëmarrja e Themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. **Ortaku themelues EMRAH ÇOBAN:** Zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme 50.00 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
 2. **Ortaku themelues BATUHAN GÜNEŞ:** Zotërues i 1 (një) kuote, me vlerë të përgjithshme 50.00 (pesëdhjetë) lekë, që përbën 50 % (pesëdhjetë përqind) të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- (2) Kontributi i Ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta).

Neni 6

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së Administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një Ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit vendoset nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) Kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) Shit-blerjes;
- c) Trashëgimisë;
- d) Dhurimit;
- e) Çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III

ORGANET VENDIMMARRËSE DHE DREJTUESE

Neni 8

Organi i Vendimarrjes

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarës i shoqërisë.

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) Ndryshimet Statutit;
- c) Emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- ç) Emërimin dhe shkarkimin e likujduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;
- dh) Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave
financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) Pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;



- gj) Riorganizimin dhe prishjen e Shoqërisë;
- h) Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti;

Ortaku mund të përfaqësohet në Asamblenë e Përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë;

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'iu dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

Neni 10

Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si:

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

- c) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasyqruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 12

Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:
 - a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
 - b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
 - c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
 - ç) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


Neni 13

Administrimi

- (1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit është 5 (pesë) vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.
- (2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
- (3) Personat e mëposhtëm caktohet si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.


Të dhënat e identifikimit:

- **EMRAH ÇOBAN**, atësia Mustafa, amësia Hafize, shtetas Turk, lindur në Elazığ / Turqi, më 12/06/1986, banues në Stamboll / Turqi, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me Nr. U26528040, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Specimenti i nënshkrimit:



- **BATUHAN GÜNEŞ**, atësia Bekir, amësia Gülbahar, shtetas Turk, lindur në Bağcılar / Turqi, më 24/10/2000, banues në Stamboll / Turqi, mbajtës i pashaportës së Republikës së Turqisë me Nr. U36307298, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar.
- Specimenti i nënshkrimit:





Neni 14

Kompetencat e Administratorëve

Administratorët kanë të drejtë që veç veç dhe/ose bashkarisht dhe detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë,
- ç) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarrëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojnë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

Administratorët janë të detyruar të therasin Asamblenë e Përgjithëshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekzistojnë rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar.

Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 15

Përgjegjësitë e Administratorit

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.



“HAYAL MOTORS” SH.P.K

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare“, administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij të përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mjedis;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personale me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkuara. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori është i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet e shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrenë padi penale kundër administratorit.

Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërblimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

Kreu IV

Viti financiar – Ekspertët

Neni 16

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombetare të Biznesit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 17

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, aë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit, eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat ëshët i detyruar që t’ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t’i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

Kreu V

Prishja – riorganizimi i shoqërisë

Neni 18

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë:

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj,
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakëve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës,

Në këtë rast Ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese “Shoqëri në likuidim e sipër”.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortakët.

Nëse Ortaket nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t’i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

“HAYAL MOTORS” SH.P.K

Neni 19

Riorganizmi i shoqërisë bashkimi – ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX, të Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2012 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare.”

Neni 20

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik në Republikën e Shqipërisë.

Neni 21

Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

ORTAKËT E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “HAYAL MOTORS”

EMRAH ÇOBAN

EMRAH ÇOBAN


BATUHAN GÜNEŞ

Batuhan Güneş




Altin Kodra
